



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:094658

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05526918

KA.nr.366/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “DPH N” me NUI 810565327 dhe seli në bulevardin Shemsi Ahmeti nr. p.nr. në Mitrovicë, kundër të paditurit Inspektorati i Punës me seli në Prishtinë, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 20.03.2024 në të cilën mori pjesë paditësi, ndërsa i padituri mungoi, më 29 mars 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet pjesërisht kërkesëpadia e paditësit “DPH N” me NUI 810565327, anulohet vendimi nr. 42/2020 i datës 27.01.2020 i Inspektoratit të Punës, Komisioni i Shkallës së Dytë dhe çështja administrative vendoset si në vijim:

- 1) Aprovohet pjesërisht ankesa e “DPH N” dhe anulohet pjesërisht vendimi për shqiptimin e masës ndëshkimore 02.nr.17-134/2019 i datës 23.10.2019 i Inspektoratit të Punës në Prishtinë në pikat me të cilat ankuesit i është shqiptuar gjobë 500€ për shkelje nga neni 10 i Ligjit nr.03/L-212 të Punës dhe 500€ për shkelje nga neni 55 para. 4 dhe 6 i Ligjit nr.03/L-212 të Punës.
- 2) Refuzohet pjesërisht ankesa e “DPH N” dhe vërtetohet pjesërisht vendimi për shqiptimin e masës ndëshkimore 02.nr.17-134/2019 i datës 23.10.2019 i Inspektoratit të Punës në Prishtinë në pikën me të cilën i është shqiptuar gjobë prej 500€ për shkelje nga neni 7 para. 4 i Ligjit nr.03/L-212 të Punës.

II. Ky aktgjykim e zëvendëson vendimin nr. 42/2020 të datës 27.01.2020 të Inspektoratit të Punës, Komisioni i Shkallës së Dytë, të anuluar si në pikën I. të këtij dispozitivi.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Padiësi përmes padisë së datës 10.08.2020 e ka iniciuar konfliktin administrativ me kërkesë për anulimin e vendimin nr. 42/2020 të datës 27.01.2020 të Inspektoratit të Punës, Komisioni i Shkallës së Dytë.
2. Në padi por edhe gjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka pretenduar se Inspektorati i Punës e ka pasur për obligim që atij t'ia dorëzoj raportin e inspektimit të datës 15.10.2019, ndërsa me asnjë provë nuk mund ta provoj që iu ka dorëzuar atij ai raport. Ka shtuar se në ditën e inspektimit përmes telefonit ishte njoftuar për inspektimin dhe i ka kërkuar disa ditë për dorëzimin dokumenteve të kërkuara, ndërsa në momentin kur kishte dashur t'i dorëzonte ato dokumentet, atij i është dorëzuar vendimi i shkallës së parë për shqiptimin e gjobës. Më tutje ka deklaruar se punëtorët B.B. dhe A.H. janë punëtorë të tij që mbi dhjetë vite dhe janë të regjistruar në ATK si punëtorë të tij, ndërsa F.P. ka qenë në fazën testuese dhe duke dashur t'i ik procedurave për regjistrim dhe çregjistrim, atë nuk e kishte regjistruar në ATK, pasi ia lejon ligji.
3. I Padituri me përgjigjen në padi e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e Padiësit dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj atë, ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor nuk mori fare pjesë, ndonëse ishte ftuar me rregull. Ai në përgjigje në padi e ka deklaruar se vendimi i goditur dhe arsyetimi i tij është në përputhje me të gjitha dispozitat në fuqi, ndërsa pretendimet e Padiësit nuk provohen me prova.

II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

4. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e prova. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: vendimi me nr. prot 42/2020 i datës 27.01.2020 i Inspektoratit të Punës si organ administrativ i shkallës së dytë; vendimi 02nr.17-134/2019 i Inspektoratit të Punës si organ administrativ i shkallës së parë; lista e pagave për periudhën 9 2019 në emër të padiësit të lëshuar nga ATK-ja; lista e pagave për periudhën 10 2019 në emër të padiësit të lëshuar nga ATK-ja; lista e pagave për periudhën 11 2019 në emër të padiësit të lëshuar nga ATK-ja; lista e pagave për periudhën 12 2019 në emër të padiësit të lëshuar nga ATK-ja; lista e pagave për periudhën 01 2020 në emër të padiësit të lëshuar nga ATK-ja; lista e pagave për

periudhën 02 2020 në emër të paditësit të lëshuar nga ATK-ja; kontrata e punës për kohë të caktuar e lidhur ndërmjet paditësit dhe F.P.; kontrata e punë e lidhur nga paditësi dhe A.H.; kontrata e punës e lidhur nga paditësi dhe B.B. lista e punëtorëve për periudhën 2019 në emër të paditësi të lëshuar nga ATK; ankesën e paditësit ndaj vendimit të shkallës së parë të inspektoratit të punës;

5. Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, gjykata duke vepruar sipas obligimit ligjor nga neni 43 para. 1 i LKA-së, gjithashtu i shqyrtoi të gjitha shkresat e lëndës në procedurën administrative që i ka paraprirë aktit administrativ të goditur, të cilat i Padituri ia kishte dorëzuar gjykatës përmes përgjigjes në padi.
6. Në bazë këtyre provave gjykata konstaton se Inspektorati i Punës më 15.10.2019 e kishte inspektuar Paditësin dhe kishte konstatuar se aty punojnë tre punëtorë, gjegjësisht B.B., A.H. dhe F.P.. Në atë rast Inspektorati i Punës e kishte obliguar Paditësin që deri më 17.10.2019 në orën 10:00 t'ia dorëzoj atij kontratat e punës, dëshmi për lajmërimin e punëtorëve në ATK dhe regjistrin e pagave për punëtorët e sapo cekur, pa e cekur se cilën periudhë kohore duhet ta përfshijnë këto dokumente. Gjatë inspektimit nuk kishte qenë prezent pronari i Paditësit, por punëtori B.B.. Këto fakt gjykata i vërtetoi përmes procesverbalit nr. 17/134 të datës 15.10.2019.
7. Më 23.10.2019 Inspektorati i Punës e kishte dhënë vendimin për shqiptimin e masës ndëshkimore 02.nr.17-134/2019 me të cilin e kishte gjobitur Paditësin me 500€ për shkelje të nenit 7 para. 4 të Ligjit 03/L-212 të Punës (këtu e tutje LP), 500€ për shkelje të nenit 10 të LP-së dhe 500€ për shkelje të nenit 55 para. 4 dhe 6 të LP-së. Lartësinë e gjobave e kishte caktuar në bazë të udhëzimit administrativ nr. 07/2012 për Përcaktimin e Gjobave dhe Shumave Konkrete për Shkelje të Ligjit të Punës (këtu e tutje UA 07/2012). Këto fakt gjykata i vërtetoi përmes vendimit të sapo cekur.
8. Në një datë të pacaktuar Paditësit kishte ushtruar ankesës kundër vendimit të cekur më lartë, të cilës ia kishte bashkëngjitur listën e punëtorëve për vitin 2019 të lëshuar nga ATK dhe kontratën e punës për F.B.. Këto fakte gjykata i vërtetoi sipas ankesës së sapo cekur, si pjesë e shkresave të lëndës administrative.
9. Më 27.01.2020 Inspektorati i Punës përmes Komisionit të Organit të Shkallës së Dytë e ka dhënë vendimin nr. 42/2020, me të cilin e ka refuzuar ankesën e Paditësit dhe e ka vërtetuar vendimin e ankimuar të shkallës së parë.

10. Gjykata gjithashtu konstaton se Padiësi i ka pasur të regjistruar në ATK si punëtor B.B. dhe A.H. gjatë vitit 2019, si dhe janar dhe shkurt 2020, për të cilët ka paguar paga. Këtë fakte gjykata i vërtetoi përmes listës së pagave për periudhën e cekur shtator 2019 deri shkurt 2020 të lëshuar nga ATK dhe nga lista e punëtorëve për vitin 2019 të lëshuar nga ATK.
11. Në anën tjetër nuk ishte kontestuese se Padiësi nuk e kishte të regjistruar fare në ATK punëtorin F.P., meqenëse vet Padiësi e kishte deklaruar këtë në seancën e shqyrtimit kryesor.
12. Gjithashtu gjykata gjen se Padiësi kishte kontrata pune të lidhura me punëtorët B.B., A.H. dhe F.P.. Këto fakte gjykata i vërtetoi përmes kontratave të punës për këta punëtorë.

III. Vlerësimi meritore i rastit

13. Gjykata e shqyrtoi kërkesëpadinë e Padiësit dhe gjeti se ajo e është e pjesërisht e bazuar, ndërsa vendimi i goditur duhet të anulohet dhe çështje të vendoset nga vet gjykata.
14. Gjykata gjen se neni 10 i LP-së e përcakton se kontrata duhet të lidhet në formë të shkruara, si dhe e ka përcaktuar përmbajtjen e saj. Gjithashtu me atë nen rregullohen edhe kushtet për lidhjen e kontratës dhe afatin për të cilën lidhet ajo. Në bazë të gjendjes faktike të konstatuar më lartë, gjykata gjen se Padiësi kishte lidhur kontrata të punës sipas nenit 10 të LP-së me të gjithë punëtorët e cekur në procesverbalin e inspektimit, rrjedhimisht gjykata vjen në përfundim se Padiësi nuk ka kryer shkelje të këtij neni. Prandaj, shqiptimi i gjobës sipas nenit 7 para. 2 nënpara. 2.2 të UA 07/2012 nuk ka mbështetje faktike, rrjedhimisht është i kundërligjshëm.
15. Gjithashtu, sipas neni 55 para. 4 të LP-së *“Punëdhënësi duhet të nxjerrë një deklaratë për çdo pagesë dhe çdo shtesë tjetër të paguar të të punësuarve. Pagat mund të paguhet përmes transferit bankar ose me para të gatshme me ç’rast punëdhënësi duhet të mbajë regjistrin për pagesat e bëra”*, ndërsa sipas para. 6 të së njëjtit nen *“Paga, paguhet në afatet e përcaktuara me Kontratë Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ose Kontratën e Punës, më së paku një (1) herë në muaj”*. Nga këto dispozita rrjedh se punëdhënësi duhet t’ia paguaj punëtorëve pagën dhe për çdo pagesë të mbaj shënime, pa e përcaktuar formën mbajtjes së shënimeve. Për këtë gjykatë, lista e pagave të

deklaruar në ATK paraqesin të dhënat të mjaftueshme për përmbushjen e detyrimit nga neni 55 para. 4 dhe 6 të LP-së. Në anën tjetër, në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë me të cilat do të provohej se pagesat e pagave nuk janë kryer sipas obligimit kontraktual dhe të deklaruar në ATK. Gjykata rikujton se i Padituri nuk e kishte caktuar periudhën kohore për të cilën i kishte kërkuar këto të dhenar, rrjedhimisht gjykata e vjen në përfundim se Paditësi me deklarin e pagave në ATK dhe nxjerrjen e listave të tilla e kishte përmbushur detyrimin e tij nga neni 55 para. 4 dhe 6 i LP-së, prandaj shqiptimi i gjobës sipas nenit 7 para. 2 nënpara. 2.24 të UA 07/2012 nuk ka mbështetje faktike. Për këto arsye gjykata e anuloi aktin administrativ të shkallës së parë lidhur me gjobën e shqiptuar në bazë të këtij neni.

16. Përveç kësaj, neni 7 para. 4 i LP-së “*Për pagesën e kontributeve dhe detyrimeve tjera ligjore, punëdhënësi është i detyruar që të punësuarin t’a lajmërojë në Administratën Tatimore të Kosovës, institucionet e tjera të cilat i menaxhojnë dhe administrojnë skemat e obligueshme pensionale dhe skemat e tjera të obligueshme*”. Siç rrjedh nga ky paragraf, punëdhënësi duhet ta regjistroj në ATK dhe çdo regjistër që shërben për qëllime të kontributeve dhe skemave të obligueshme pensionale. Me vet faktin që LP këtë obligim e lidh me pagesën e kontributeve, atëherë kjo nënkupton se punëdhënësi regjistrimin e punëtorit duhet ta bëjë më së voni me rastin e pagesës së parë të pagës, për të cilën duhet të paguhet tatim dhe kontribute të obligueshme. Në anën tjetër, në LP ose në ligjet përkatëse që i rregullojnë tatime dhe kontributet pensionale nuk ka asnjë përjashtim nga deklarimi i punëtorit në ATK në kuptim të periudhë kohore ose për kategori të caktuar të punëdhënësve ose punëmarrësve. Në rastin konkret, Paditësi nuk e kishte regjistruar punëtorin F.P. as pas inspektimit të Inspektoratit të Punës, rrjedhimisht nuk e ka përmbushur obligimin që ka dal nga neni i cituar më lartë. Prandaj gjykata vjen në përfundim se Paditësi e kishte shkelur nenin 7 para. 4 të LP duke mos e deklaruar punëtorin F.P. në ATK, rrjedhimisht shqiptimi i gjobës ka qenë i drejtë.

17. Për arsyet cekura më lartë, gjykata gjeti se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet dhe karakteri i çështjes e lejon që gjykata të vendos me juridiksion të plotë, si dhe të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, rrjedhimisht me aktgjykim vendosi për çështjen administrative, siç mundëson neni 46 para. 4 i LKA-së. Po ashtu, në bazë të njëjtit paragraf gjykata rikujtoi se ky aktgjykim e zëvendëson aktin e anuluar.

18. Prandaj, duke u bazuar në nenet 13 para. 1 nën para. 1.12 lidhur me para. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të LKA-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës
Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative
KA.nr.366/2022
Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.